



Prania / Presenca Gjithmires/Protitudo Rregjistrimi / Delivety	30.12.2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organi / Sh. Dimesa Org. Unit	Rr. Prist Rr. Prist Rr. Prist	Shtet / Pretog Appetias	Sasia Kufizna Quantity
SKPMShCK	6422/2021		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1174/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1174/2021 të datës 10.12.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."Enver Maloku" banesa e tregtisë hyrja 3 Nr.18, Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.1174/2021 të datës 10.12.2021 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 10.12.2021, në formë elektronike ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6170/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit Nr.ref. BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për Ndryshim dhe Plotësimin e Rregullores së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë Nr. 2/2021 dhe Njoftimit individual të datës 12.11.2021 për uljen e pagës në masën 25%.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1174/2021 të datës 10.12.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin nga M.A. për ankesa.kpmschck i datës 10.12.2021; E-mail nga M.A. për ankesa.kpmschck i datës 17.12.2021; Vendimin me Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021; Rregulloren nr.2/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së pagave të nëpunësve të Agjencisë e datës 29.10.2021; Shkresën e datës 01.04.2012; E-mail nga Pak Salary Statement për M.A. i datës 12.11.2021; Aneksin e AktEmërimit e datës 05.03.2018; Akt Emërimit e



datës 19.07.2017; Përshkrimin e Detyrave të Punës; E-mail nga Pak Info për Pak All i datës 11.11.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit

sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja më datë 10.12.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit Nr.ref BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Ndryshim dhe Plotësimin e Rregullores së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë Nr.2/2021 dhe Njoftimit individual të datës 12.11.2021 për uljen e pagës në masën 25%, ndërsa e njëjta me datë 17.12.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 6218/2021, për tërheqjen e ankesës të datës 10.12.2021, andaj, bazuar në këtë veprim të ankueses e në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar me ankesën e me numër A.nr.1174/2021 të datës 10.12.2021.

Ashtu siç u konstatua si me lartë, Kolegji pasi shqyrtoj shkresat e lëndës dhe bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.Nr.1174/2021

Çlirim Zeka



Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses Majlinda Ademaj;
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimi ;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.